



Nr. Ref. BD-228/1

Në bazë të nenit 14.1, 15.2.3, 16.3 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 10.5 të Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Nenit 35 të Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publik (ndryshuar me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik – ka hyr në fuqi me datë 17 qershor 2025), Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 04 korrik 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e z. Ibrahim Gjylderren për lirim nga detyra u.d. Drejtor Ekzekutiv të ofruar përmes e-mailit të datës 03 korrik 2025 me efekt prej datës së këtij vendimi. I njëjti vazhdon mandatin sipas akt emërimit në detyrën ZDE Funksione të Përgjithshme.
- II. Emërohet z. Burim Leci në pozitën Ushtrues detyre të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për periudhën duke filluar nga data 07 korrik 2025 deri në finalizimin e konkursit publik për rekrutim të kësaj pozite përmes emërimit nga Bordi.
- III. Emërohet z. Petrit Ibraj në pozitën Ushtrues detyre të Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv Operativë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për periudhën duke filluar nga 07 korrik 2025 deri në finalizimin e konkursit publik për pozitën Drejtor Ekzekutiv përmes emërimit nga Bordi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Kryesuesit për emërimin sipas dispozitivit të këtij vendimi dhe duke marr parasysh faktet sikurse në vijim:

Me datë 17 qershor 2025 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHC) morri vendimin A. Nr. 682/2025 të KPMSHC (pranuar në AKP me datë 26 qershor 2025 nr. protokoli 3095) dhe me anë të cilit është anuluar konkursin për pozitën Drejtor Ekzekutiv nën nr. reference RN000165111 i AKP-së. Bordi në zbatim të vendimit në fjalë të Këshillit A. Nr. 682/2025 në mbledhjen e datës 30 qershor 2025 morri vendim nr. ref. BD-227-2 për të anuluar konkursin dhe me datë 04.07.2025 ka njoftuar KPMSHC-në për implementim të vendimit A. Nr. 682/2025.

Megjithatë duke u bazuar në vendimin e KPMSHC-së A. Nr. 682/2025 njëra ndër arsytet për anulim të konkursit është që z. Gjylderren në pozitën ud DE është emëruar në kundërshtim me paragrafët 1,2,3 të nenit 51 të Ligjit Nr.08/L097 dhe paragrafët 1,24 të nenit 18 të Rregullores 15/2023 për procedurën e pranimit në shërbim civil (ndryshuar me Rregulloren 05/2024) – sepse duhej të kishin kaluar 6 muaj nga dita e pranimit si ZDE FP në Agjenci për tu emëruar në pozitë tjetër si u.d. DE, ndërsa z. Gjylderren ka filluar punën në Agjenci me 01.09.2024 ndërsa në pozitën u.d. DE ka filluar me datë 22.11.2024 – respektivisht nuk kishin kaluar 6 muaj. Respektivisht vendimi KPMSHC-së A. Nr. 682/2025 thotë që kësaj z. Gjylderren nuk është dashur të emërohet as në Komision pranues për pozitën DE. Këshilli duke u bazuar në dispozitat

MA



e mësipërme ligjore dhe shtuar këtu edhe nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit NR.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative ka anuluar konkursin.

Po ashtu potencohet që me datë 03 korrik 2025 përmes e-mailit z. Ibrahim Gjyliden ka kërkuar nga Bordi që ta lirojnë nga pozita e u.d. Drejtorit Ekzekutiv (por jo prej pozitës ZDE FP).

Bordi duke shqyrtuar atë që u tha më sipër, pra vendimin e KPMSHC-së A. Nr. 682/2025 dhe njoftimin e datës 03.07.2025 të z. Gjyliden për tërheqje nga u.d.DE, ka paraparë të nevojshme që të emërohet ushtruesi i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv z. Burim Leci dhe ushtruesit të detyrës të ZDE Operativë z. Petrit Ibraj duke filluar nga data 07 korrik 2025 si dhe z. Ibrahim Gjyliden të kthehet në pozitën e ZDE Funksionet e Përgjithshme në mënyrë që mandati dhe detyrat e Agjencisë të vazhdojnë të funksionojnë sipas procedurave. Propozimet për emërimet në u.d.DE dhe u.d DE O janë bërë duke pasqyruar faktet që z. Leci me datë 15 korrik 2025 mbush 1 (një) vit si i punësuar në Agjenci në pozitën ZDE O që është pozitë e lartë drejtuese, ndërsa z. Ibraj në pozitën që ka sipas akt emërimit është Drejtor i Departamentit të Koordinimit rajonal që është pozitë e mesme drejtuese.

Bordi duke qenë organi kompetent për të emëruar Menaxhmentin si kompetencë e pa-delegueshme vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 04 korrik 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit